

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2006

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 28 pika 3 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2006 dhe me raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni,

- duke njohur rolin e këtij institucioni për sigurimin e depozitave të shtetasve, të vendosura në institucionet bankare që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë dhe për kompensimin e tyre në rast të falimentimit të ndonjë institucioni bankar,

konstaton se:

- veprimtaria e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Komisioni vlerëson pozitivisht veprimtarinë e këtij institucioni për:

- rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Autoritetin Mbikëqyrës (Bankën e Shqipërisë), për kontrollin e saktësisë së primit të llogaritur nga institucionet bankare, të siguruara pranë këtij institucioni dhe për vlerësimin e gjendjes financiare të tyre, me qëllim rritjen e sigurisë së sistemit bankar;

- administrimin me efektivitet të mjeteve financiare dhe arritjen e rezultatit financiar pozitiv, duke zbatuar politikat e institucionit për investimin e fondeve në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare.

Komisioni kërkon që për vitin 2007 Agjencia e Sigurimit të Depozitave të thellojë më tej përpjekjet në drejtim të:

- kryerjes së studimeve të plota dhe të thelluara për sfidat e skemave të sigurimeve të depozitave në procesin e integritetit të vendit;

- njohjes në kohë të direktivave europiane në fushën e sigurimit të depozitave;

- përmirësimit dhe plotësimit në kohë të kuadrit ligjor e nënligjor të veprimtarisë së institucionit, në përputhje me ndryshimet e ndodhura në vend, bazuar edhe në përvojat më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare;

- aplikimit të teknologjive bashkëkohore, që lehtësojnë manaxhimin e Agjencisë dhe sidomos përmbushjen e misionit të saj;

- shtimit dhe zgjerimit të veprimtarisë trajnuese të stafit të institucionit, me qëllim rritjen e profesionalizmit të tij.

31 maj 2007